



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Shkurt 2021

Nr: 78

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË ALEANCA KOMBËTARE PËR  
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS  
25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Partia Aleanca Kombëtare, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Partia Aleanca Kombëtare, me shkronja nistore “P.A.K”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z. Krenar Tahiri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen më datë 25 Prill 2021, administruar me nr. 1149 prot., datë 12.02.2021.

Kërkesa e paraqitur nga Partia Aleanca Kombëtare, respekton afatin kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga Partia Aleanca Kombëtare, për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, përbëhet si më poshtë:

- a) Vërtetimi lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 12.02.2021, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia Aleanca Kombëtare, me initiale



Data: 15 Shkurt 2021

Nr. 78

Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Aleanca Kombëtare si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin të datës 25 Prill 2021

“P.A.K”, me Kryetar z. Krenar Tahiri, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;

- b) emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë;
- ç) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- d) specimeni i vulës së partisë;
- dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (z. Aurela Xheferi);
- e) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në (z. Asllan Hysaj);
- ë) deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet;
- f) deklaratën e partisë Model 01/1 për hapjen e llogarisë së posaçme nga kryetari i partisë.

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia Aleanca Kombëtare, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

#### **V E N D O S :**

1. Të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, “Partia Aleanca Kombëtare”, me Kryetar z. Krenar Tahiri, me shkronjat nistore “P.A.K”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

